



KURBAN BAJRAMI, MOMENT PËR T'U NDARË NGA PËRKATËSITË ILUZIVE QË NJERIUN E MBAJNË TË LIDHUR PAS MIRAZHEVE...



"STAMBOLLI ËSHTË NJË QYTET TURK DHE MYSLIMAN DHE I TILLË DO TË MBETET!"



NATYRA BARBARE E TË VJETËRVE DHE E TË RINJVE

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 24 - Nr. 5 (279), Maj, 2026

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

Bayram, shënd e verë!



CEREMONIA E PËRCJELLJES SË HAXHILERËVE TË SHKODRËS 1447/2026

NXËNËSIT E MEJTEPEVE FETARE PËRKUJTOJNË 1-VJETORIN E KONSTRUKSIONIT TË XHAMISË SË PLUMBIT

DITA E ARAFATIT DHE SIMBOLIKA E KURBAN BAJRAMIT

MESAZHE TË DOBISHME NË PRAG TË 10 DITËVE TË DHULHIXHES NGA XHAMITË E SHKODRËS

KURBAN BAJRAMI Mbledh mijëra besimtarë në sheshin e fushë çelës

TRADITA E FESTIMIT ME FËMIJËT PËR KURBAN BAJRAM



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

KURBAN BAJRAMI, MOMENT PËR T'U NDARË NGA PËRKATËSITË ILUZIVE QË NJERIUN E MBAJNË TË LIDHUR PAS MIRAZHEVE TË RREME!

Sot është momenti që të gjithë ne të shohim në familjet tona, në rrethet tona shoqërore, në realitetin ku jetojmë për të bërë mirë, për të ndërtuar të mirën, për t'u ndarë nga e keqja, për ta ndaluar të keqen, për të mos lejuar që tentakulat e shejtanit të përhapen gjithandej në familjet tona, në realitetet tona, në shoqërinë tonë.

Të dashur dhe të shtrenjtë motra dhe vëllezër besimtarë,

Sot është dita e begatë e Arefatit, më e mira ditë e vitit. Ditë në të cilën Zoti i gjithësisë sheh me mëshirën e Tij, me bujarinë dhe me faljen e Tij të pakufishme vëllezërit dhe motrat tanë në fushën e Arefatit! Na sheh të gjithëve ne në përkushtimin dhe angazhimin tonë për të qëndruar besnikë drejt thirrjes së Kur'anit Famëlartë dhe mësimëve të Pejgamberit (alejhis-selam).

Sot është dita, kur të gjithë ne bashkërisht thërrasim me të madhe se nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Sot është dita, kur thërrasim me të madhe "Allahu Ekber" për të dëbuar errësirat e shejtanit të mallkuar nga jeta jonë e përditshme.

Sot është momenti për t'u ndarë nga përkatësitë iluzive që njeriun e mbajnë të lidhur pas mirazheve të rreme që e bëjnë rob e skllav të shejtanit

të mallkuar. Sot është dita, kur nuk është parë ndonjëherë shejtani më i poshtëruar përpara gjithësisë, sepse njerëzit me të madhe thërrasin se nuk ka zot tjetër përveç Allahut Fuqiptotë!

Sot është momenti që të gjithë ne të shohim në familjet tona, në rrethet tona shoqërore, në realitetin ku jetojmë për të bërë mirë, për të ndërtuar të mirën, për t'u ndarë nga e keqja, për ta ndaluar të keqen, për të mos lejuar që tentakulat e shejtanit të përhapen gjithandej në familjet tona, në realitetet tona, në shoqërinë tonë. Sepse në fund të fundit, njeriu ka ardhur në këtë botë me një mision të shenjtë, për ta ndërtuar jetën, për ta zhvilluar atë, por mbi bazat e asaj çfarë Zoti i gjithësisë do nga gjithsecili prej nesh, jo mbi bazat e asaj që shejtani i mallkuar thërret dhe frymëzon pasuesit e tij moment pas momenti e ditë pas dite.

Të dashur dhe të shtrenjtë,

Nesër është dita e Kurban Bajramit,

një ditë e madhe feste për muslimanët e mbarë globit. Një ditë në të cilën jemi të ftuar që të shohim në familjet tona, në shoqërinë tonë, në realitetet tona, për të shtrirë duart e pajtimit e të harmonisë, për të dëbuar të keqen dhe për ta bërë lanet shejtanit, për t'u parë gëzimi në fytyrat tona e mbi të gjitha, për të gëzuar zemrat tona me besimin në Zotin Një e për t'u afruar moment pas momenti e kohë pas kohe me dritën e Tij e për të shkruar pas udhëzimit të Tij, që jetës sonë i jep kuptimet e vërteta të fjalës Jetë!

Ju uroj me zemër dhe lutem që Allahu Fuqiptotë ta bekojë Shkodrën tonë, banorët e saj dhe të na falë mëshirë dhe paqtim për të jetuar në harmoni dhe vëllazëri me njëri-tjetrin dhe për ta shijuar mirësinë e besimit sa të jemi në këtë botë ne dhe fëmijët tanë deri në ditën e fundit.

Allahu ju dashtë dhe ju begatoftë!

Me zemër të mirë Kurban Bajramin!



"STAMBOLLI ËSHTË NJË QYTET TURK DHE MYSLIMAN DHE I TILLË DO TË MBETET!"

PRESIDENTI ERDOĞAN:

"Stambolli është një qytet turk dhe mysliman dhe i tillë do të mbetet deri në ditën e kiametit!"



Në nuk do ta lëmë këtë qytet të dashur në mëshirën e të paafteve; përkundrazi, do të vazhdojmë t'i shërbejmë dhe të realizojmë projektet gjigante që i shkojnë atij.

Pas 86 vitesh privimi dhe ndarjeje, ne i thyem zinxhirët që ishin vendosur mbi dyert e Aja Sofias dhe e mbyllëm atë plagë, që ishte hapur në zemrën e çlirimit, dhe nuk do të lejojmë kurrë që Stambolli të ndahet nga çlirimi dhe nga shpirti i çlirimit të tij.

Edhe përkundër mbetjeve bizantine, akoma e kanë të vështirë ta pranojnë





këtë të vërtetë, Stambolli është një qytet turk dhe mysliman, dhe do të mbetet i tillë deri në ditën e kiametit, me lejen e Allahut.

Nuk do ta lëmë këtë qytet të dashur në mëshirën e të paafteve që u mungojnë aftësia, njohja e historisë dhe vlerësimi i vlerave të saj. Përkundrazi, ne do të vazhdojmë t'i shërbejmë Stambollit, të investojmë në të dhe të zbatojmë projektet gjigante që i shkojnë atij!"

Recep Tayyip Erdoğan

President i Turkijes

(www.instagram.com/aja.turkiyee)



HASAN EL-BASRIU
(642 - 728)




Ndihmoje veten ndaj të këqijave të yjetra me të mira të reja!

Sepse, ju nuk do të gjeni diçka më të mirë për fshirjen e një të keqeje të vjetër, se sa një mirë të re.

Vërtetësinë e kësaj gjëje unë e gjej në Librin e Allahut:

"Me të vërtetë, të mirat i fshijnë të këqijat!"



Sheikh Muhamed El-Gazali
(1917 – 1996)

NATYRA BARBARE E TË VJETËRVE DHE E TË RINJVE

Mashtrimi përmes titujve është një gjë me të vërtetë e urryer dhe duket se evropianët, të vjetrit dhe të rinjtë, dinë ta bëjnë mirë këtë art të mashtrimit, dhe ecin pas tij në drejtim të qëllimeve të tyre. Kështu që, nën thirrjen për paqe përgatiten për luftë dhe dinë ta bëjnë mirë industrinë e vdekjes.

Mashtrimi përmes titujve është një gjë me të vërtetë e urryer dhe duket se evropianët, të vjetrit dhe të rinjtë, dinë ta bëjnë mirë këtë art të mashtrimit, dhe ecin pas tij në drejtim të qëllimeve të tyre. Kështu që, nën thirrjen për paqe përgatiten për luftë dhe dinë ta bëjnë mirë industrinë e vdekjes.

Nën ngjyra prej qytetërimit kryejnë lloj-lloj mizorish dhe e thyejnë në mes kurrizin e popujve me borxhe dhe dhimbje. Prej këtyre (mizorive), përveç një pakicë (e vogël ka mbetur), që dëshmojnë atë çfarë i ka goditur baballarët e tyre prej persekutimeve dhe shfarosjeve.

Në të njëjtën kohë, ku njerëz të tillë fshehin kthetrat dhe thonjtë e tyre pas kafazeve të mëndafsh, i përshkruajnë të tjerët me çfarë ata janë të pastër (të pafajshëm)!

Kështu, mbrojtësit e tokës dhe nderit të tyre janë terroristë. Myslimanët i përhapin parimet e besimit të tyre me shpatë! Islami është fe materialiste që i shërben instinkteve! Ndërsa, ata janë njerëz shpirtërorë, që nuk kanë shembull të ngjashëm në të kaluarën dhe në të tashmen.

Dhe, kërkon për këtë shpirtërore të pretenduar, e nuk e gjen, veçse në netët

e tyre të kuqe dhe në klubet e tyre të stërmbushura me mëkate.

Profesor Omer Abid e përcjell këtë paragraf nga shkrintari francez Gustaf Lubon, që përshkruan bëmat e kryqtarëve kur e pushtuan Bejtul-Makdisin në fund të shekullit të 4-të hixhri, duke thënë: “Populli ynë vërtiteshin si egërsirat, të cilave u janë grabitur të vegjlit e tyre, nëpër rrugë, sheshe dhe tarraca shtëpish për të shuar mllefin e tyre të vrasjeve; ata thernin fëmijët, të rinjtë dhe pleqtë, i grinin copa-copë. Nuk linin prapa, qoftë edhe një njeri të vetëm dhe i varnin njerëzit me një litar me qëllim që të mos u merrte kohë shumë! Turma që rridhnin si lumenjtë përgjatë qytetit të mbuluar me kufoma!

Pastaj, Bohemondi solli të gjithë ata që kishte arrestuar në kullën e kështjellës dhe urdhëroi t’u pritët koka pleqve, të moshuarve dhe të dobëtëve”.

Gustaf Lubon e rinis përshkrimin e tij të zymtë, duke thënë: “Populli ynë e ka stërkalar cakun në derdhjen e gjakut në Tempullin e Sulejmanit. Kufomat dhe të vranët kishin mbuluar tërë sheshin anekënd! Duart dhe krahët e prerë kërcenin sikur kërkonin të bashkoheshin me trupat e kufomave të huaja. Kryqtarët deshën të pushonin

prej lodhjeve të kasaphanës ndaj banorëve mbarë, kështu që u zhytën në gjëra ndaj të cilave njeriu ndjen neveri prej alkoolit dhe shturjeve”.

Myslimanët janë njerëz harrues dhe hutues. Ata kanë hedhur perde ndaj kësaj historie të tmerrshme e shëmtuar dhe pak kujtojnë prej saj, veçse shkurtimisht dhe kalimthi. Bile, ata nuk e kujtuan, veçse pasi e rikthyen Bejtul-Makdisin dhe shpallën faljen e përgjithshme ndaj bijve kriminelë, të cilët kishin kryer tërë ato masakra në tokën e saj të mjerueshme.

Ja kjo është Evropa, që ka ofruar sionizmin për të marrë Bejtul-Makdisin (Aksanë) nga myslimanët edhe një herë tjetër, përveçse jehuditë këtë herë i kanë lënë pas titujt mashtrues dhe u kanë thënë myslimanëve: Ju nuk keni vend këtu! Njëri nga ne do të qëndrojnë mbi rrënojat e tjetrit!

Si thua, çfarë do të bëjnë myslimanët?!

A do të qëndrojnë siç i shohim: “I shkatërrojnë shtëpitë e tyre me duart e tyre dhe duart e armikut”?!

(Nga libri: *El-Hak El-Murr*, v. 3, f. 135)

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:
Lavdrim Hamja



Naim Drijaj
Imam - Xhamia Parrucë

Edukimi i fëmijëve, sidomos në kohën tonë dhe në vendin ku jetojmë, është një nga sfidat më të mëdha për prindërit. Ibn Omeri (r.a) ka thënë: “Edukoje fëmijën tënd, sepse ti je përgjegjës për të se me çfarë e ke edukuar?! Çfarë e ke mësuar?! Ndërsa ai është përgjegjës për bamirësinë dhe bindjen ndaj teje!”¹

Ka shumë gjëra që duhet të kemi parasysh në edukimin e fëmijëve, por unë dua të përmend tri çështje me rëndësi, të cilat ndikojnë thellësisht në formimin e tyre dhe mendoj që, sot na mungojnë shumë.

1. Çështja e parë që ka të bëjë me edukimin e fëmijëve është se prindi duhet të kuptojë dhe të dijë se edukimi i fëmijëve në frymën e duhur është një përgjegjësi që ai do të japë llogari për të para Allahut të Madhëruar. Allahu do ta pyesë njeriun për fëmijët e tij: a i ke edukuar, a i ke mësuar dhe a i ke udhëzuar në rrugën e drejtë.

Allahu (xh.sh) në Kur’an thotë: “O ju, qet besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri.”² Aliu (r.a) e ka komentuar këtë ajet duke thënë: “Edukojeni familjen tuaj dhe mësojeni atë.” Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Çdonjëri prej jush është përgjegjës për familjen e tij.”³

Fillimisht, mësimi dhe edukimi nënkuptojnë t’i mësojmë fëmijës kush është Zoti i tij, kush është Pejgamberi i tij, cila është feja e tij, kush e ka krijuar, kush e begaton dhe kush e furnizon. Duhet t’i mësojmë gjithashtu kujt duhet t’i lutet dhe t’i përulet. Po ashtu, fëmija duhet të njihet me obligimet themelore ndaj Zotit të tij, siç janë besimi i

1. Transmeton Bejhakui në “Shu’ab el-Iman”.
2. Kur’ani, Et-Tahrim: 6.
3. Transmeton Buhari.

EDUKIMI I FËMIJËVE

Edukimi i fëmijëve, sidomos në kohën tonë dhe në vendin ku jetojmë, është një nga sfidat më të mëdha për prindërit. Ibn Omeri (r.a) ka thënë: “Edukoje fëmijën tënd, sepse ti je përgjegjës për të se me çfarë e ke edukuar?! Çfarë e ke mësuar?! Ndërsa ai është përgjegjës për bamirësinë dhe bindjen ndaj teje!”

drejtë, namazi dhe veprimet e tjera të përditshme që formojnë karakterin dhe besimin e tij.

Shikoni, Pejgamberi (a.s) ua ka mësuar besimin edhe fëmijëve, jo vetëm të rriturve. Pejgamberi (a.s) kur e ka këshilluar Ibn Abasin, ai nuk i kishte më shumë se dhjetë vjeç. Pejgamberi (a.s) i ka thënë Abdullah ibn Abasit (r.a): Ruaje Allahun,⁴ Allahu do të të ruajë ty!⁵

Ruaje Allahun, Allahun do ta gjesh para teje!⁶ Nëse kërkon ndihmë, kërko vetëm prej Allahut!⁷

Kur fëmija edukohet në këtë mënyrë dhe ushqehet me këtë frymë, me lejen e Allahut, ai më pas do të jetë shumë i kujdesshëm.

2. Gjithashtu, nga ato që duhet t’i mësojmë dhe t’i edukojmë fëmijët tanë janë vlerat tona. Cilat janë këto vlera? Dashuria, respekti, turpi. Duke i mësuar fëmijët të kuptojnë turpin në kuptimin islam, një turp që përfshin një forcë të brendshme dhe vepruese: i shtyn ata të kryejnë obligimet e tyre dhe i pengon të bëjnë punë të këqija. Duhet t’i mësojmë

4. Urdhri “ruaje Allahun” do të thotë ruajë fenë e Tij, mësoje fenë e Tij, respektoje madhësitë e Tij në urdhrat dhe ndalesat kur’anore, zbatoji porositet dhe përmbajju ligjeve islame etj.

5. Në këtë fragment profetik përmendet një parim thelbësor: çfarëdo që të mbjellësh dhe të kultivosh, do të korrësh. Pra, nëse ruan, ruhesh; nëse mbështetesh, ndihmohesh; nëse duron, fiton; nëse kujton, kujtohesh; nëse i lutesh dhe e falënderon në bollëk, do të gjesh përgjigjen e lutjeve në fukarallëk; nëse fiton dashurinë e Tij me punë të mira në gjendje mirësie, do të të ndihmojë Ai në gjendje vështirësie; kush bën mirë, meriton shpërblimin dhe kush bën keq, do të gjejë ndëshkimin.

6. Nëse besimtari tregohet korrekt me normat hyjnore, Allahu është me të në çdo situatë, i dhuron sukses dhe mbarësi. Një nga dijetarët e gjeneratave të para të muslimanëve i shkroi një letër mikut të tij: “Nëse Allahu është me ty (në krahu tënd), nga kush ke frikë? Nëse Allahu është kundër teje, nga kush shpreson ndihmë?
7. Transmeton Tirmidhiu dhe Imam Ahmedi.

fëmijët të respektojnë të moshuarit, të duan të tjerët, të jenë bujarë dhe të mos jenë koprracë. Të jenë krenarë për fenë e tyre, që të mos ndihen të kompleksuar për namazin që duhet ta falin kur vjen koha e tij. Dhe shumë vlera të tjera. Këto janë disa nga vlerat tona (ka edhe shumë vlera të tjera) me të cilat duhet t’i edukojmë fëmijët tanë.

3. Gjithashtu, nga ato vlera që duhet t’i mësojmë dhe t’i edukojmë fëmijët tanë është edhe rëndësia e shembullit dhe modelit. Duhet t’i mësojmë se cilën rrugë duhet të ndjekin dhe kujt duhet t’i ngjajnë. Fatkeqësisht, sot fëmijët tanë shpesh janë të orientuar drejt modeleve që nuk janë të duhura. Prandaj, duhet t’u tregojmë shembuj të Profetëve, të sahabëve dhe dijetarëve tanë të hershëm.

Allahu (xh.sh) na ka treguar shumë histori të pejgamberëve në Kur’an, që t’i kemi model dhe të marrim shembull prej tyre. Për shembull, Ejubi (a.s) sa vite ka qenë i sëmurë, por ka bërë durim. Jusufi (a.s) u provokua nga një grua e bukur dhe me pozitë, e cila i ofroi shumë të mira të kësaj bote, por Jusufi tha: “O Zot, burgu është më i dashur për mua se paturpësia tek e cila po më fton.”⁸ Këto janë vlerat tona dhe me këto shembuj duhet t’i edukojmë fëmijët tanë.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Edukimi i mirë është trashëgimia më me vlerë të cilën mund t’ia lë pas prindi fëmijës së tij.”⁹

Allahu i ruajt fëmijët dhe rininë tonë. Allahu i udhëzofitë në rrugën e drejtë dhe i bëftë më të mirë e më të devotshëm se ne. Allahu ua mundësoftë që çdo sfidë në jetë ta përballojnë dhe ta kalojnë me sukses, ashtu si duhet, në frymën e asaj që na ka mësuar Allahu dhe Pejgamberi (a.s).

8. Kur’ani, Jusuf, 33.
9. Transmeton Tirmidhiu dhe Imam Ahmedi.



Arben Halluni, teolog

BUDIZMI DHE TEORIA E RRUGËS SË MESME

Lumturia e vërtetë në Islam nuk arrihet me shuarjen e vetëdijes apo me ikjen nga jeta, por me njohjen e Allahut (xh.sh), besimin e drejtë dhe veprën e mirë. Prandaj Allahu i Lartësuar thotë: “Ata që besuan dhe zemrat e tyre qetësohen me përmendjen e Allahut. Vërtet, me përmendjen e Allahut qetësohen zemrat.”

Thuhet se njerëzit besojnë në dualitete, duke menduar se çdo gjë ose është ekzistuese ose joekzistuese. Mirëpo, vëzhguesi i drejtë e kupton se të dyja skajet janë të gabuara dhe se e vërteta qëndron në mes tyre.

Mbi këtë bazë, budizmi mbron unitetin e personalitetit njerëzor, sepse sipas tij nuk ekziston një realitet i qëndrueshëm që mbetet i pandryshuar. Njeriut i duket sikur ka një identitet të vetëm, por kjo është vetëm si rezultat i rrjedhës së pandërprerë të përjetimeve dhe imazheve të lëvizshme, ashtu siç na duket një figurë e vetme në ekranin e kinemasë, ndërsa në të vërtetë ajo përbëhet nga një varg i gjatë pamjesh, ngjyrash dhe hijesh.

Nëse shpëtimi gjendet në largimin nga të dy skajet, atëherë ai nuk arrihet veçse përmes ekuilibrit ndërmjet tyre. Vetëm kështu hiqet perdja e mashtrimit që mbulon para syve tanë pamjen e jashtme të gjërave dhe na mundësohet të depërtojmë në thelbin dhe fshehtësinë e ekzistencës.

Prandaj, nuk kërkohet zhytja e tepruar në kënaqësitë shqisore, por as mohimi i plotë i tyre. Rruga e drejtë është mesatarja në çështjet kryesore të jetës: në të kuptuarit, vendosmërinë, fjalën, sjelljen, jetesën, veprimin, meditimin dhe gëzimin.

Në të kuptuarit, dy skajet janë: të besosh çdo gjë që thuhet ose të mohosh çdo gjë që thuhet. Rruga e mesme është dallimi midis asaj që mbetet dhe asaj që zhdoket, midis së dukshmes dhe së fshehtës, midis së vërtetës së qëndrueshme dhe asaj që nuk ka themel.

Në vendosmëri, dy skajet janë dobësia dhe neglizhenca. Rruga e mesme është vullneti i mençur, kur njeriu e di qartë rrugën e drejtë dhe e ndjek atë.

Në të folur, dy skajet janë heshtja e dëmshme dhe fjalët e kota. Rruga e mesme është fjala e vërtetë dhe ruajtja e gjuhës nga shpifja, përgojimi dhe gjuha e pahijshme.

Në sjellje, dy skajet janë teprimi dhe neglizhenca. Rruga e mesme është drejtësia që nuk anon nga asnjëra anë.

Në jetesë, drejtësia qëndron në sigurimin e një furnizimi hallall, pa dëmtuar të tjerët.

Në veprim, njeriu i drejtë e njeh detyrën e vet, i mat mundësitë sipas qëllimit dhe ecën me urtësi, maturi dhe largim nga iluzionet e pasionet.

Nirvana sipas budizmit

Gëzimi i vërtetë, sipas tyre, është kënaqësia që i jepet njeriut në këtë jetë përmes asaj që ata e quajnë “nirvana tokësore”, e cila është një parapërgatitje për nirvanën e përjetshme. Nirvana nënkupton qetësimin, shuarjen ose zhdokjen. Disa mendimtarë modernë e shpjegojnë atë si shkrirjen e të gjitha

ngjyrave në bardhësinë e pastër, e cila vetë nuk ka ngjyrë, por është vendtakimi i të gjitha ngjyrave.

Me këtë disiplinë, njeriu shpëton nga rrota e pafund e lindjes dhe vdekjes, duke kaluar nga një jetë në tjetrën dhe nga një trup në një tjetër. Ai hyn në “nirvanë”, ku sipas tyre nuk ka më lindje e as vdekje.

Kjo, sipas tyre, është urtësia e fshehur pas sundimit të perëndive, engjëjve, qiejve dhe tokës. Të gjitha këto janë të nënshtruara ndaj ligjit të fatit dhe caktimit; prandaj duhen parë si mundësi për pastrim, ndryshim dhe përgatitje drejt shuarjes së fundit.

Megjithatë, këtu qëndron edhe kundërtënia e kësaj filozofie. Ajo mbron personalitetin njerëzor dhe kënaqësitë e shpirtit, por njëkohësisht beson në kalimin e shpirtit nga një trup në tjetrin. Nëse personaliteti nuk ekziston, çfarë është ajo që kalon nga një jetë në tjetrën?

Budizmi beson në një ekzistencë absolute dhe të përhershme, por në të njëjtën kohë mbron qenien individuale të njeriut. Ndërsa nëse e tëra është diçka tjetër përveç pjesëve të saj, atëherë nuk mund të mohohet krejtësisht realiteti i individit.

Duhet të kemi kujdes nga disa interpretime perëndimore të budizmit, sepse shumë prej tyre i atribuojnë kësaj filozofie mendime që pasqyrojnë më shumë prirjet e mendimtarëve modernë

sesa vetë budizmin.

Disa e kanë lartësuar budizmin pa masë dhe e kanë paraqitur si kulmin e guximit intelektual në përballje me problemet e universit. Mirëpo, një vështrim i kujdesshëm tregon se ai nuk është guxim racional, por më tepër një reagim i lindur nga lodhja ndaj botës së shqisave dhe pasioneve.

Në fund, budizmi nuk është gjë tjetër veçse një përpjekje për t’u larguar nga vuajtja e jetës përmes ikjes nga bota e ndjenjave dhe e dëshirave, ndërsa lumturia e tij më e lartë përfundon në shuarjen e vetëdijes ose në atë që quhet “mosqenie”, sipas mënyrës më të mirë me të cilën mund të përshkruhet.

Nga këndvështrimi i akides, budizmi përpriqet ta zgjidhë problemin e vuajtjes njerëzore duke kërkuar shpëtimin në shuarjen e dëshirave dhe në arritjen e “nirvanës”, ndërsa Islami e sheh njeriun si një krijesë të nderuar, me shpirt, trup dhe personalitet të veçantë, të krijuar për të adhuruar Zotin Madhniplotë dhe për të jetuar sipas udhëzimit të Tij.

Kur’ani Famëlartë e pohon qartë ekzistencën e shpirtit, përgjegjësinë individuale dhe ringjalljen pas vdekjes, duke e kundërshtuar çdo ide që çon në mohimin e personalitetit njerëzor apo në shkrirjen e tij në një ekzistencë të paqartë.

Allahu i Madhëruar thotë: “A mendon njeriu se do të lihet pa përgjegjësi?” - (El-Kijame, 36)

Ndërsa për qëllimin e krijimit të njeriut, Allahu thotë: “Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër, veçse që të Më adhurojnë.” - (Edh-Dharijat, 56)

Lumturia e vërtetë në Islam nuk arrihet me shuarjen e vetëdijes apo me ikjen nga jeta, por me njohjen e Allahut (xh.sh), besimin e drejtë dhe veprën e mirë. Prandaj Allahu i Lartësuar thotë: “Ata që besuan dhe zemrat e tyre qetësohen me përmendjen e Allahut. Vërtet, me përmendjen e Allahut qetësohen zemrat.” - (Er-Ra’d, 28)

Prandaj, besimtari e sheh shpëtimin jo në zhdokjen e qenies së tij, por në adhurimin e Krijuesit, në pastrimin e shpirtit dhe në shpresën për takimin me Zotin e tij në botën e amshuar, ku lumturia është e plotë dhe e përhershme.

“Kush punon mirë, qoftë mashkull apo femër, duke qenë besimtar, Ne do t’i japim një jetë të mirë dhe do t’i shpërblejmë sipas veprave më të mira që kanë bërë.” - (En-Nahl, 97).

MESAZHE TË DOBISHME NË PRAG TË 10 DITËVE TË DHULHIXHES NGA XHAMITË E SHKODRËS



Me udhëzim të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ditën e xhuma, më 15 maj 2026, në të gjitha xhamitë e Shkodrës u ligjërua rreth vlerës së ditëve të Dhulhixhes, që sivjet nisim me datën 18 maj 2026 dhe që kulmojnë me ditën e Arafatit që pason me ditën e madhe të Kurban Bajramit.

Ditët e Dhulhixhes kanë një vlerë shumë të madhe në fenë islame. Burimi i kësaj mirësie gjendet në Kur’anin Famëlartë, ku në suren El-Fexhr, Allahu i Madhëruar urdhëron e thotë: “Pasha agimin! Pasha dhjetë netët! Pasha çiftin dhe pasha tekun! Pasha natën që shkon! A janë këto betime për të mençurin?”

Poashtu, i Dërguari i Allahut, Hz. Muhammedi (a.s) urdhëron e thotë: “Nuk ka ditë, që veprat e mira janë më të dashura tek Allahu, se sa në këto 10 ditë”. I thanë: As edhe xhihadi në rrugë të Allahut? Pejgamberi (a.s) tha: “As edhe xhihadi në rrugën e Allahut, përveç atij, i cili sakrifikon në rrugën e Zotit me pasurinë dhe me jetën e tij”. - (Transmeton Buhariu)

Kësisoj, në mbarë botën islame, besimtarët përkushtohet për të rregulluar adhurimet e tyre, për të shtuar bamirësitë dhe për të dëshmuar solidaritetin e tyre me njerëzit në nevojë në rrugën e afrimit me Zotin e gjithësisë.

Këto mesazhe e shumë të tjera që lidhen me këtë atmosferë të begatë, u transmetuan edhe sot në xhamitë e ndryshme të Shkodrës, ku imamët e

nderuar patën mirësinë të udhëzojnë besimtarët drejt vlerës dhe madhësisë së këtyre ditëve që përkojnë edhe me shtyllën e pestë të fesë islame, Haxhin.

Sikurse dihet çdo vit në këtë periudhë të shenjtë të vitit, haxhilerë nga mbarë bota vërshojnë drejt Vendeve të Shenjta për kryerjen e këtij adhurimi të shumëpritur për mbarë ymetin islam.

Edhe sivjet nga qyteti i Shkodrës dhe nga mbarë Shqipëria me qindra besimtarë janë bërë gati dhe pas pak ditësh pritet të nisen drejt Mekës së Shenjtë për kryerjen e ritualeve të Haxhit.

Myftinia Shkodër ju fton që ta shfrytëzoni maksimalisht këtë periudhë të begatë që fillon me datën 18 maj 2026 dhe vazhdon deri me datën 27 maj 2026.

Agjërimi i këtyre ditëve është me shumë vlerë, poashtu dhikri, leximi i Kur’anit Famëlartë, bamirësia, sadekatë, etj.

Kulmi i kësaj periudhe të begatë është Dita e Arafatit, agjërimi i së cilës ka një vlerë të posaçme në traditën e Hz. Muhamedit (a.s) dhe dita e Kurban Bajramit, një festë e madhe për mbarë ymetin islam, ku besimtarët që kanë mundësi janë të ftuar për të bërë kurbanet e tyre si shenjë afrimi me Zotin e gjithësisë, si përkujtim i ndodhisë së madhe të Hz. Ibrahimit (a.s) dhe të birit, Hz. Ismailit (a.s), dhe si dëshmim i solidarizimit që muslimanët kanë me njëri-tjetrin.

MR. FEHIM ABAZI, KRYETAR I RI I KOMUNITETIT MUSLIMAN SHQIPTAR TË ZVICRËS

Zgjedhja u bë gjatë Kuvendit të rregullt të mbajtur të dielën në xhaminë e Friburgut, ku morën pjesë 106 delegatë nga e gjithë Zvicra

E hënë, më 3.5.2026

Komuniteti Musliman Shqiptar në Zvicër (KMSHZ) ka zgjedhur udhëheqësin e ri. Mr. Fehim Abazi, imam në Lozanë, është votuar për kryetar pas tërheqjes nga gara të kryetarit të deritanishëm, Hfz. Mehas Alija.

Zgjedhja u bë gjatë Kuvendit të rregullt të mbajtur të dielën në xhaminë e Friburgut, ku morën pjesë 106 delegatë nga e gjithë Zvicra. Me këtë vendim, drejtimi i KMSHZ-së kalon nga pjesa gjermanfolëse e vendit në atë frankofone. Punimet e Kuvendit nisën në një atmosferë të qetë pune, me miratimin e rendit të ditës dhe shqyrtimin e raporteve vjetore.

Kryetari në largim, Hfz. Mehas Alija, prezantoi aktivitetet e vitit 2025, duke theksuar se janë realizuar rreth 40 iniciativa në fusha fetare, arsimore, sociale dhe institucionale.

“Është një vullm pune që kërkon përkushtim dhe koordinim të vazhdueshëm”, theksoi Alija.

Delegatët miratuan gjithashtu raportin financiar, i cili u vlerësua pozitivisht edhe nga revizorët profesionalë. Në kuadër të vendimmarrjes, Kuvendi aprovoi disa ndryshime në rregulloren e punës dhe pranoi tri xhami të reja si anëtare. Me këtë, numri i xhamive shqiptare në kuadër të KMSHZ-së arrin në 67.



Gara për kryetar fillimisht përfshinte dy kandidatë: Hfz. Mehas Alija dhe Mr. Fehim Abazi. Megjithatë, pak para votimit, Alija njoftoi tërheqjen e tij, duke hapur rrugë zgjedhjes së Abazit.

Në fjalën e tij përmbyllëse, Alija falënderoi bashkëpunëtorët për mbështetjen gjatë një dekade angazhimi, duke veçuar si arritje kryesore bashkimin e dy bashkësive islame shqiptare në vitin 2020.

“Ky ka qenë një rrugëtim i përbashkët, me sfida dhe suksese, për të cilin ndihem mirënjohës. Kemi ndërtuar ura bashkëpunimi, kemi mbështetur imamët dhe kryesitë. Kemi qenë bashkë në ditë të mira dhe të vështira. Kemi realizuar unifikimin e 64 xhamive shqiptare brenda KMSHZ së, kemi rritur buxhetin, kemi themeluar disa departamente. Është puna më e mirë pas formimit të shkollave shqipe dhe themelimit të xhamive, dhe për këtë jemi krenar” u shpreh Hfz. Mehas Alija në mbyllje të fjalimit.

Si kandidat i vetëm, Mr. Fehim

Abazi u votua nga delegatët dhe mori drejtimin e organizatës.

Në deklaratën e tij të parë, ai theksoi nevojën për unitet dhe komunikim të drejtpërdrejtë me komunitetin.

“Është një përgjegjësi e madhe. Prioritet do të jetë forcimi i unitetit dhe kontakti i drejtpërdrejtë me çdo xhami në vend”, tha Abazi, duke shtuar se planifikon vizita në të gjitha qendrat gjatë vitit të parë të mandatit.

Kuvendi zgjodhi gjithashtu një kryesi prej 11 anëtarësh, e përbërë nga imamë, përfaqësues të xhamive dhe tri gra nga sektori civil. Lista e propozuar u shpalo nga Komisioni zgjedhor, i udhëhequr nga H. Ferid Zeqiri, dhe u miratua me shumicë votash.

Në përmbyllje të punimeve, u ndanë mirënjohje për kontributet gjatë vitit të kaluar, ndërsa nikoqirët e xhamisë së Friburgut organizuan një darkë për pjesëmarrësit.

(www.albinfo.ch)



MYFTIU I SHKODRËS UROI MR. FEHIM ABAZIN ME RASTIN E PËRZGJEDHJES NË KRYE TË KMSH NË ZVICËR

Shumë i dashur vëllai im, Mr. Fehim ef. Abazi, Kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër,

Më lejoni që nëpërmjet kësaj shkrese, t'ju përcjell urimet dhe lutjet e mia më të përzemërta me rastin e përzgjedhjes tuaj në krye të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër.

Nuk ka dyshim se ardhja juaj në krye të institucionit më të rëndësishëm islam të myslimanëve shqiptarë në Zvicër vjen në një kohë, kur më shumë se asnjëherë të gjithë ne kemi nevojë për drejtues të aftë, të urtë, largpamës, me përvojë suksesi dhe që gëzojnë respektin dhe nderimin e besimtarëve dhe përtej tyre.

Dhe jam i bindur se ju jeni në lartësinë e duhur të kësaj pozite që me meritë e keni fituar falë aktivitetit tuaj të palodhshëm ndër vite, në vendlindje dhe tashmë në diasporë në Zvicër.

Falë përkushtimit tuaj, përvojave të fituara, aktivitetit të larmishëm, urtësisë dhe largpamësisë, durimit dhe sakrificës për të mirën e Thirrjes Islame dhe çështjes kombëtare, ju keni

arritur të përbushni imazhin e prijësit fetar dhe drejtuesit të aftë që i bën nder institucionit të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër.

Për këtë lutem me zemër që Allahu i Madhëruar t'ju japë mbarësi dhe bekim, t'ju ndriçojë rrugën dhe t'ju lartësojë me suksese të mëtejshme për të çuar përpara aktivitetin e larmishëm të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër nëpërmjet xhamive dhe qendrave islame shqiptare në shtetin helvet.

Sikurse shpresoj dhe lutem që Allahu i Madhëruar t'ju japë suksese të vazhdueshme për të rritur përherë e më shumë prezantimin dinjitoz të KMSHZ-së, jo vetëm në Zvicër, por në çdo vend ku prania e një drejtuesi të urtë dhe largpamës i bën nder çdo aktiviteti, tribune a vendtubimi të myslimanëve anembanë botës.

Allahu ju dhashtë sukses, ju pastë në mbrojtje dhe e begatofte rrugëtimin tuaj të ri!

Me nderime e lutje:

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

Nr. 88 Prot. Dt. 09 / 5 / 2026

URIM

Lënda: Urim me rastin e përzgjedhjes në krye të KMSH në Zvicër
Drejtuar: Hirësisë së Tij, Mr. Fehim ef. Abazi, Kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër

Shumë i dashur vëllai im, Mr. Fehim ef. Abazi,
Kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër,

Më lejoni që nëpërmjet kësaj shkrese, t'ju përcjell urimet dhe lutjet e mia më të përzemërta me rastin e përzgjedhjes tuaj në krye të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër.

Nuk ka dyshim se ardhja juaj në krye të institucionit më të rëndësishëm islam të myslimanëve shqiptarë në Zvicër vjen në një kohë, kur më shumë se asnjëherë të gjithë ne kemi nevojë për drejtues të aftë, të urtë, largpamës, me përvojë suksesi dhe që gëzojnë respektin dhe nderimin e besimtarëve dhe përtej tyre.

Dhe jam i bindur se ju jeni në lartësinë e duhur të kësaj pozite që me meritë e keni fituar falë aktivitetit tuaj të palodhshëm ndër vite, në vendlindje dhe tashmë në diasporë në Zvicër.

Falë përkushtimit tuaj, përvojave të fituara, aktivitetit të larmishëm, urtësisë dhe largpamësisë, durimit dhe sakrificës për të mirën e Thirrjes Islame dhe çështjes kombëtare, ju keni arritur të përbushni imazhin e prijësit fetar dhe drejtuesit të aftë që i bën nder institucionit të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër.

Për këtë lutem me zemër që Allahu i Madhëruar t'ju japë mbarësi dhe bekim, t'ju ndriçojë rrugën dhe t'ju lartësojë me suksese të mëtejshme për të çuar përpara aktivitetin e larmishëm të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër nëpërmjet xhamive dhe qendrave islame shqiptare në shtetin helvet.

Sikurse shpresoj dhe lutem që Allahu i Madhëruar t'ju japë suksese të vazhdueshme për të rritur përherë e më shumë prezantimin dinjitoz të KMSHZ-së, jo vetëm në Zvicër, por në çdo vend ku prania e një drejtuesi të urtë dhe largpamës i bën nder çdo aktiviteti, tribune a vendtubimi të myslimanëve anembanë botës.

Allahu ju dhashtë sukses, ju pastë në mbrojtje dhe e begatofte rrugëtimin tuaj të ri!

Me nderime e lutje:
Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Myftinia Shkodër, thesh "Zogu" i, Përrudë; [Cf. 067 435 3880; web: www.myftinia-shkodër.org; e-mail: mail@myftinia-shkodër.org]



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

“

Nuk ka

besuar asnjëri

prej jush,

derisa të dojë

për vëllanë e tij,

atë që do

për veten e tij!

Ahmedi, Bukhariu, Muslimi,
Tirmidhiu, Nesaiu dhe Ibn Maxheh

KURBAN BAJRAMI

MBLEDH MIJËRA BESIMTARË NË SHESHIN E FUSHË ÇELËS

Ditën e mërkurë, më 27 maj 2026 që në mëngjes herët, besimtarët muslimanë shkodranë u mbledhën bri xhamisë “Ebu Bekër”, në sheshin e vakëfit të shenjtë të Fushë Çelës, për të falur namazin e Kurban Bajramit, i cili tashmë është bërë traditë të falet në shesh.

Në këtë ditë të gëzuar feste, Myftinia Shkodër organizon ceremoninë e faljes së Kurban Bajramit me ligjëratat të larmishme, ku besimtarët e pranishëm, të cilët kanë mbushur sheshin plot, pasi falin së bashku namazin e sabahut, dëgjojnë imamët dhe teologët e Shkodrës.

Ceremonia e festës së Kurban Bajramit filloi me faljen e namazit të sabahut, i cili u drejtua H. Durim Kasemi, imam i xhamisë së Parrucës dhe pastaj teologu Arben Halluni prezantoi programin e kësaj ceremonie, që vazhdoi me ligjëratat e mbajtura nga imamët e nderuar: H. Durim Kasemi – “Dita e Kurban Bajramit dhe kriza në marrëdhëniet e njerëzve”, H. Ensar Ismailaj – “Hz. Ismaili, fëmija model dhe edukimi në peshoren e besimit”, H. Idmir Plaku – “Haxhi, shtyllë e fesë, bashkim për ymetin” dhe H. Lavdrim Hamja – “Simbolika e gjuajtjes së guralecëve dhe shoqëria në prag gremine”.

Përmes ligjëratave të tyre, imamët dhe teologët e nderuar përçuan mesazhe dhe këshilla me vlerë rreth Islami dhe mesimeve të tij.

Pastaj fjalën e mori Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili iu drejtua të pranishmëve me një mesazh, ku u përqendrua tek disa prej plagëve të shoqërisë shqiptare dhe asaj botërore, duke vënë theksin tek domosdoshmëria e kthimit të njeriut nga harta e udhëzimit hyjnor.

Myftiu theksoi se, njeriu i kësaj kohe e ka humbur busullën e orientimit dhe po shohim se sa më shumë largohet nga besimi dhe udhëzimi hyjnor, aq më i egër dhe primitiv bëhet ai dhe jeta e tij mbi faqen e dheut.

Myftiu nuk la pa përmendur edhe një plagë të madhe sociale të vendit tonë, që është largimi masiv i të rinjve dhe elitave të këtij vendi jashtë Shqipërisë, për çka ai solli në vëmendje fjalën e madhe të dijetarit të shquar Shkodranë me famë botërore, Hirësisë së tij, Shejkh Vehbi S. Gavoçi (rahmeti i Allahut), i cili porosiste: “Shqiptarët kanë ndërthur botën mor djalë, por tashmë duhet që ata të kthehen dhe të rindërtojnë vendin e tyre!”

Myftiu ndër të tjera theksoi edhe: “Edhe se ne nuk duam që fëmijët tanë të rriten sipas metodave dhe udhëzimit të femohuesve dhe të atyre që nuk e njohin Zotin dhe nuk e llogarisin atë në përditshmërinë e tyre!”

Gjithashtu, në fjalën e tij, Myftiu i Shkodrës vuri theksin edhe tek ajo që konsiderohet si një ndër aktet më të shëmtuara të grabitjes flagrante të vakëfit, pronës së shenjtë të muslimanëve shkodranë në zemër të qyteti, ku po ndërtohet një projekt i ri mbi tokën e vakëfit shekullor të Fushë Çelës.

Myftiu tërhoqi vëmendjen e të pranishmëve edhe për rëndësinë që ka dëshmimi i Islamit në përditshmërinë tonë, duke u fokusuar tek praktika e përditshme e mesazhit hyjnor larg fjalëve, pretendimeve dhe diskurseve të panevojshme, që nuk sjellin asnjë dobi në përditshmërinë tonë.

Myftiu u lut për bekime dhe mbarësi për qytetin e Shkodrës, për banorët e saj, për mbarë popullin shqiptar dhe ymetin islam në veçanti.

Pas përfundimit të fjalës së Myftiut u zhvillua edhe falja e namazit të Kurban Bajramit, të cilin e drejtoi Imam Muhamed B. Sytari dhe më pas ceremonia përfundoi me hytben e Kurban Bajramit të mbajtur nga H. Naim Drijaj, i cili dha disa mesazhe me vlerë që lidhen me kuptimet e Haxhit dhe rëndësinë e kësaj shtylle të Islami në jetën e besimtarëve.



TRADITA E FESTIMIT ME FËMIJËT PËR KURBAN BAJRAM

Dita e parë e Kurban Bajramit të sivjeshëm erdhi plot dritë e rreze dielli për qindra fëmijë, të cilët u mblodhën në oborrin e xhamisë së Parrucës për të festuar sëbashku, në një organizim plot vlerë në gjurmët e një tradite që sa vjen e merr formë e legjitimitet.

Në fjalën e rastit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, u lut për bekime e shëndet, mirësi e lumturi për fëmijët tanë, duke theksuar se gëzimi

i fëmijëve na jep dritë e shpresë të gjithëve dhe ia shton vlerat shoqërisë.

Myftiu falënderoi edhe ekipin e mësueseve dhe vajzave vullnetare, që nën drejtimin e edukatores Kimete Sylja, bënë një punë të madhe plot përkushtim e dashuri për fëmijët.

Mbi një mijë pako me dhurata, vizatime, recitime e lojëra argëtuese, nën shoqërinë e ilahive të përzgjedhura për këtë event, ia shtuan gjallërinë

kësaj dite të bekuar, duke përcjell një mesazh të madh për të gjithë: Më shumë investim për fëmijët, më shumë dritë për shoqërinë!

Prindër të shumtë shfaqën falënderime e mirënjohje për Myftininë Shkodër për këtë aktivitet, duke u shprehur të gatshëm që të japin kontributet e tyre në çdo kohë, për shtimin e këtyre hapësirave argëtuese dhe edukative për fëmijët e tyre.



NXËNËSIT E MEJTEPEVE FETARE PËRKUJTOJNË 1-VJETORIN E KONSTRUKSIONIT TË XHAMISË SË PLUMBIT

Në kuadër të përkujtimit të 1-vjetorit të rihapjes së Xhamisë së Plumbit, pas rikonstruksionit të saj, Myftinia Shkodër planifikoi një sërë aktivitete me nxënës të mejtepeve. Ditën e shtunë më 2 maj 2026 u organizua një aktivitet i veçantë me pjesëmarrjen e nxënësve të kurseve fetare nga Qendra Kulturore Krye-Bushat, xhamia Shkëzë, xhamia Ura e Bunës dhe xhamia Kullaj.

Aktiviteti nisi me pritjen e nxënësve të mejtepeve dhe një vizitë në ambientet e jashtme dhe të brendshme të xhamisë, duke u njohur nga afër me vlerat historike dhe shpirtërore të saj.

Programi vijoi me lexim Kur'ani dhe recitime të përzgjedhura nga nxënësit, të cilat krijuan një atmosferë të ngrohtë dhe reflektuese për të gjithë të pranishmit.

Në fjalën e tij përshëndetëse, drejtuesi i arsimit pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, vlerësoi rëndësinë e edukimit fetar dhe rolin e xhamisë si vatër e dijes dhe e formimit moral të brezave të rinj.

Teologu Halluni bëri një falënderim



të veçantë për të gjithë pjesëmarrësit dhe kryesisht për mësuesit H. Ridvan Luzaku, H. Sami Plori dhe H. Ardin Selhani për përkushtimin e tyre të vyer në aspekt të edukimit të fëmijëve me vlerat e besimit dhe moralit

Pas faljes së namazit të drekës, aktiviteti vijoi me qerasje simbolike dhe një foto e përbashkët për të përmbyllur këtë aktivitet të bukur.

VIZITË DHE PROGRAM EDUKATIV ME NXËNËSIT E MEJTEPEVE NË XHAMINË E PLUMBIT

Në këtë atmosferë të begatë, ditën e enjte më, 7 maj 2026, u zhvillua një tjetër aktivitet i veçantë me pjesëmarrjen e nxënësve të kurseve fetare nga Qendra Kulturore Oblikë, xhamia Velinaj dhe xhamia Zues.

Aktiviteti nisi me pritjen e nxënësve të mejtepeve dhe një vizitë në ambientet e jashtme dhe të brendshme të xhamisë, ku ata u njohën nga afër me vlerat historike, kulturore dhe shpirtërore të këtij objekti të rëndësishëm të trashëgimisë islame.

Më pas, programi vijoi me lexim nga Kur'ani Famëlartë dhe recitime të përzgjedhura nga nxënësit, duke krijuar

një atmosferë të ngrohtë edukative dhe shpirtërore për të gjithë të pranishmit.

Në fjalën e tij përshëndetëse, drejtuesi i arsimit pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, vlerësoi rëndësinë e vizitës së nxënësve në këtë simbol të besimit dhe trashëgimisë fetare, duke theksuar rolin e xhamisë si vatër e dijes, edukimit dhe formimit moral të brezave të rinj më frymën e vërtetë islame.

Gjithashtu, teologu Halluni shprehu falënderime të veçanta për të gjithë pjesëmarrësit, e në mënyrë të posaçme për mësuesen znj. Kimete Elezi dhe mësuesin H. Nebi Alia, për përkushtimin e tyre në



edukimin e fëmijëve me vlerat e besimit dhe moralit.

Pas faljes së namazit të iqindisë, aktiviteti vijoi me një qerasje simbolike dhe u përmbyll me një foto të përbashkët, si kujtim nga ky aktivitet i bukur përkujtimor.



I DËRGUARI I ALLAHUT (A.S)
KA THËNË:

“

*Haxhi
i pranuar
nuk ka
shpërblim
tjetër,
vecse
xhenetin!*

(Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

PËRFUNDOI ME SUKSES PROGRAMI TREDITOR ME TË REGJISTRUARIT PËR HAXHIN E SIVJETSHËM

Haxhi është një prej pesë shtyllave të fesë islame, që tërheq vit pas viti me miliona besimtarë nga mbarë bota, që mbledhen së bashku për kryerjen e ritualeve të këtij adhurimi shumë të dashur për zemrat e besimtarëve.

Edhe sivjet, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, ka organizuar regjistrimet e të interesuarve nga krejt qytetet tona, që me afrimin e muajit të shenjtë Dhulhixhe bëhen gati të nisen drejt vendeve të shenjta.

Në këtë frymë, Myftinia Shkodër, gjatë periudhës 11-13 maj 2026, zhvilloi programin e trajnimit të grupit të besimtarëve muslimanë nga Shkodra, që kanë kryer procedurat e regjistrimit për Haxhin e sivjetshëm.

Programi i trajnimit i ditës së sotme u hap nga teologu Arben Halluni, i cili foli për rëndësinë, vlerën shpirtërore dhe mesazhin që përcjell Haxhi në jetën e besimtarit muslimanë.

Për gjatë këtyre tri ditëve, u zhvilluan disa seanca informuese, me shpjegimin e ritualeve të Haxhit, me pyetje-përgjigje e njohuri që i shërbejnë grupit të haxhilerëve të këtij viti.

U shfaqën edhe dy dokumentarë të përgatitur nga Myftinia Shkodër, për të nxjerrë në pah vlerat e Ujit Zemzem dhe mirësitë e Medines së Ndriçuar.

Në përmbyllje, të këtij trajnimi pati edhe një përshëndetje nga përfaqësuesi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Eriol Haxhiu, i cili tregoi për mënyrën dhe organizimin e Haxhit në vitet e kaluara, por edhe për organizimin e bërë për Haxhin e këtij viti, si dhe uroi haxhilerët për një udhëtim të lehtë dhe të pranuar.

Gjithashtu, sot u bë edhe shpërndarja e materialeve të Haxhit, broshura, ihramët, vizat e Haxhit, kartat dhe udhëzimet e nevojshme për grupin e haxhilerëve të Shkodrës para nisjes drejt vendeve të shenjta, të cilët do të udhëhiqen nga H. Altin Nikshiqi.



CEREMONIA E PËRCJELLJES SË HAXHILERËVE TË SHKODRËS 1447/2026



Ditën e hënë, më 18 maj 2026, në një atmosferë të begatë plot emocione, u zhvillua ceremonia e përcjelljes së haxhilerëve të Shkodrës për këtë vit.

Në prag të faljes së namazit të mesditës në xhaminë e Parrucës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, u lut për grupin e haxhive të këtij viti, sikurse theksoi se prania e tyre në mesin e miliona haxhilerëve nga mbarë

bota, është një bekim i madh për mbarë Shkodrën dhe kombin shqiptar.

Në një mesazh para mediave të pranishme, Myftiu Sytari, theksoi se përcjellja e haxhilerëve të Shkodrës është një traditë shekullore e muslimanëve të Shkodrës, si dhe një gëzim shumë i madh për të gjithë, për faktin e simbolikës që mbart në vete ky udhëtim jete.

Familjarë të shumtë, miq dhe dashamirë, uruan grupin prej 40 besimtarëve, që sot do të nisen nga aeroporti i Podgoricës, në një udhëtim direkt për në Xhidah, prej ku do të vazhdojnë udhëtimin drejt Mekës së bekuar për të hyrë në atmosferën e ritualeve të Haxhit të këtij viti.

Myftinia Shkodër uron rrugë të mbarë dhe adhurime të pranuar për haxhilerët e shtrenjtë!



LAJMËRIME TË DOBISHME NË PRAG TË KURBAN BAJRAMIT 1447/2026

Dita e hënë, më 18 maj 2026 është dita e parë e muajit dhulhixhe 1447, që shënon edhe fillimin e periudhës së begatë të dhjetë ditëve të mira të përmendura në Kur'anin Famëlartë, në fillimin e sures El-Fexhr.

- Ditën e martë, më 26 maj 2026 – 9 dhulhixhe 1447, bota islame përkujton Ditën e Madhërisme të Arefatit, më e mira ditë adhurimi e vitit!

Ajo na lidh shpirtërisht me tubimin e mrekullueshëm të haxhilerëve në fushën e Arefatit, begatitë dhe mirësitë e së cilës janë të pallogaritshme!

- Pejgamberi (a.s) na ka mësuar se: "Lutja më e mirë është lutja e Ditës së Arefatit dhe, fjalët më të mira që kam thënë unë dhe të dërguarit para meje, janë: La ilahe il-lall-llahu vahdehu la sherike lehu. Lehul-mulku ve lehul-hamdu ve huve ala kul-li shej'in kadîr!", siç transmetohet nga Imam Tirmidhiu.

- Është e pëlqyer që muslimani ta agjërojë Ditën e Arefatit, sepse i Dërguari (a.s) ka thënë: "Për agjërimin e Ditës së Arefatit, shpresoj që Allahu do të shlyejë gjynahet e vitit para dhe atij që vjen!", siç transmetohet nga Imam Muslimi.

- Tekbiret e teshrikut janë vaxhib dhe këndohen pas çdo namazi farz, vetëm, a me xhemat, në këtë periudhë: duke nisur pas namazit të sabahut të ditës së Arefatit, deri për namaz të iqindisë së ditës së katërt të Kurban Bajramit. (Këtë vit, nga sabahu i datës 26 maj 2026, deri për iqindi të datës 30 maj 2025).

- Tekbiret e teshrikut janë: "All-llahu ekber, All-llahu ekber, All-llahu ekber! La ilahe il-lall-llahu huval-llahu ekber! All-llahu ekber ve lil-lahil-hamd!", thuhet

menjëherë pas kryerjes së namazit farz, pa e prishur me fjalë, biseda, ngritje në këmbë a dalje nga xhamia.

- Kurban. Quhet kështu, sepse ai është afrim me Allahun e Madhëruar, për të Cilin bëhet dhe vetëm Atij i drejtohet!

- Koha e kryerjes së kurbanit nis nga momenti pas përfundimit të namazit të Kurban Bajramit dhe përgjatë ditëve të teshrikut, pra, përgjatë katër ditëve të këtij bajrami.

- Kurban është ripërtëritje e traditës së Hz. Ibrahimit (a.s), që iu dorëzua thirrjes së Zotit për të bërë kurban të birin, Hz. Ismailin (a.s), dorëzim që u shpërblye me këmbimin e djalit me një dash të madh.

- E pyetën Resulullahun (a.s): Çfarë është kurban? Tha: "Tradita e babait tuaj, Ibrahimit, paqja qoftë mbi të!" E pyetën: Çfarë shpërblimi kemi për të? Tha: "Për çdo qime, një e mirë!" I thanë: Po të leshtat? Tha: "Për çdo fije të leshtë, një e mirë!", siç e transmeton Imam Hakimi.

- Kurban është traditë e Resulullahut (a.s), për të cilin mësojmë se: "Resulullahu (a.s) jetoj në Medinë dhjetë vite dhe përherë bënte kurban", siç e transmeton Imam Tirmidhiu, nga Ibni Omeri (r.a).

- Hoxha i jonë, H. Vehbi S. Gavoçi, na mëson se: "Llojet e kurbanit janë tre: devetë, lopët dhe dhentë. Edhe çjapi është si dhentë, të gjinisë mashkullore qofshin, a femërore. Kështu bëhen tetë çifte, siç përmenden në Kur'anin Famëlartë:

- Ai (krijoi) tetë lloje (nga kafshët shtëpiake): prej deleve dy (dash e dele),

prej dhive dy (cjap e dhi). Thuaj: "A janë të ndaluar (haram) dy meshkuj apo dy femra apo çka mbanë (pjell) mitra e dy (llojeve të tyre) femrave?" Më tregoni, pra, me fakte të ditura (e jo me trillime) nëse jeni të sigurtë.

Ai (krijoi) edhe nga devet dy (lloje) dhe nga lopët dy (lloje). Thuaj: "A dy meshkuj i ka ndaluar (haram), a dy femra, ose çka mban mitra e dy (llojeve të tyre) femrave?" A mos ishit të pranishëm kur All-llahu ju porositi me këtë (hallall apo haram)?" E kush është më mizor se ai që trillon rrenë për All-llahun dhe ashtu t'i humbë njerëzit në mungesë të dijes. All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë mizorët.- (Kurani, El-Enam: 143-144).

- Resulullahu (a.s) na udhëzon: "Lopa, për shtatë vetë...", siç e transmeton Imam Muslimi.

- E shpërndan 1/3 (një të tretën) e kurbanit, 1/3 (një të tretën) tjetër e mban për vete dhe 1/3 (një të tretën) e mbetur, si të dojë nëse dëshiron., siç shkruan Hoxha i jonë në librin e tij: "El-Kafi", në medhhebin hanefi.

Pra, 1/3 për nevojtarë, 1/3 për vete dhe 1/3 për të afërm, farefis, komshi e ngjashëm, vallahu alem.

- Është e pëlqyer vizita e të afërmeve dhe e varrezave në ditën e Bajramit.

- Është e pëlqyer shfaqja e gëzimit dhe shpenzimi për familjarët, në ditën e bajramit.

- Është mirë që personi t'i drejtohet vëllasë së tij besimtar, në ditën e bajramit me urimin: "Allahu na e pranoftë!".

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër



DITA E ARAFATIT DHE SIMBOLIKA E KURBAN BAJRAMIT, SPECIALE DITE NË STAR PLUS TV

Ditën e martë, më 26 maj 2026, teologu Lavdrim Hamja ishte i ftuar në Star Plus Tv në emisionin Studio e Hapur, me gazetarin Teodor Gjerga për të biseduar rreth Ditës së Arafatit dhe Kurban Bajramit.

Në këtë speciale dite u zhvilluar një bashkëbisedim me vlerë rreth rëndësisë dhe vlerës së madhe të Ditës së Arafatit dhe festës së begatë të Kurban Bajramit. Gjatë speciale u realizua edhe një lidhje live me haxhilerët shkodranë, të cilët ndodhen në Haxh për të përcjell përjetimet e tyre drejtpërdrejtë nga fushën e Arafatit.



Në lidhje direkte me H. Gani Kimça teleshikuesit patën mundësi të shikonin drejtpërdrejtë haxhilerët shkodranë, por jo vetëm, dhe miliona haxhilerët të tjerë nga mbarë bota, të cilët këtë vit kanë qenë të ftuarit dhe të privilegjuarit e Zotit të gjithësisë, për të kryer Haxhin e këtij viti.

Gjatë këtij bashkëbisedimi, teologu Lavdrim Hamja shpjegoi rëndësinë e kësaj Dite Madhështore të Arafatit, ritualet kryesore të Haxhit, etapat që ndjekin haxhilerët për të kryer të plotë këtë shtyllë të rëndësishme të Islamit, etj.

PËRFUNDOI ME SUKSES THERJA DHE SHPËRNDARJA E KURBANEVE 1447/2026

Myftinia Shkodër edhe këtë vit, me rastin e festës së Kurban Bajramit 1447/2026 ka realizuar me sukses therjen dhe shpërndarjen e kurbanëve, që janë edhe simbolika e kësaj feste të begatë dhe madhështore.

Besimtarë nga Shkodra, por jo vetëm dhe gjithashtu nga vende të ndryshme të botës, si Kanadaja, Amerika, Belgjika, Kroacia, etj, si dhe shoqata dhe fondacione brenda dhe jashtë vendit, partnerë me të cilët Myftinia Shkodër ka një bashkëpunim të gjatë dhe të frytshëm, ka organizuar edhe këtë vit therjen dhe shpërndarjen e kurbanëve për njerëzit në nevojë, veçanërisht për skamnorët, jetimët, invalidët, etj.

Konkretisht janë shpërndarë më shumë se 40 kurbanë (desh dhe dele) të porositur nga besimtarët, të cilët kanë kryer pagesën e kurbanit të tyre në Myftininë Shkodër, Helping Hand USA (9 kurbanë), Fondacionin "Mirësia" me 190 pako mish kurbanit, etj.

Me këtë rast, Myftinia Shkodër



falënderon dhe shpreh mirënjohje për të gjithë ata besimtarë, shoqata dhe fondacione, që na besuan kryerjen e këtij riti dhe adhurimi fetar për vitin 1447/2026, si dhe për të gjithë ata imamë, të cilët u angazhuan në këtë proces të therjes dhe shpërndarjes së kurbanëve.

Allahun e Madhëruar e lusim t'ua pranojë secilit kurbanin e tij dhe ta shpërblejë me të mira në dynja dhe në ahiret!

MEJTEPI IM... XHAMIA E LAGJES RUS

PAK HISTORI:

- Xhamia Rus ndodhet në një nga lagjet e vjetra të qytetit, Bashkia Shkodër.

- Pas lejimit të besimit fetar në vitin 1990, meqë besimtarët e kësaj lagjeje nuk kishin xhami, ndërhyjnë në organet e pushtetit vendor dhe morën katin e parë të godinës së çerdhes që ndodhet në tokën vakëf të Myftinisë Shkodër, të cilën e adaptuan në faltore me të gjithë pajisjet e nevojshme.

- ISH MEJTEPI

Në vitin 1880, Haxhi Ali Kraja, banor i kësaj lagjeje, ndërtoi me fondet e tij



ndërtesën e mejtepit, 20-30 m larg xhamisë. Mejtepi që dykatesh, me dy dhoma poshtë e lart, që më vonë, pas vitit 1917 u kthye në shkollë fillore, ku vijoi të jepet mësim besimi. Për një kohë të gjatë këtu dha mësim fetare Hfz. Muhamet Kastrati, myezin i xhamisë së Rusit të Vogël. Me planifikimin e ndërtimeve të reja në këtë vend, mejtepi u prish. Ndër të veçantat e këtij mejtepi që dhe krijimi i grupeve të nxënësve që aktivizoheshin në festat fetare myslimane në këndimin e mevludeve, salavateve, të recitimeve, etj...

- Lagja Rus përbëhet prej rreth 400 familje myslimane.

Familjet më të njohura në lagjen Rus janë: Hoxha, Rusi, Bushati, Dinja, Cungu, Kraja, Golemi, Bakalli, Hoti, Bala, Zaganjori, etj.

- Në këtë xhami nga viti 2002 deri më sot kanë shërbyer imamë dhe mësues të mejtepeve; H. Hamza Cungu, H. Fejzi Zaganjori, H. Shukri Kaplan, H. Ritvan Luzaku, z. Armand

Uruçi, H. Besim Barbullushi dhe imami dhe mësuesi aktual H. Gilman Molla.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 15 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami, në periudha të ndryshme nga viti 2002 -2026 është rreth 210 nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Në kuadër të vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset-mejtepë e mësim-besimit, drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni, ditën e shtunë, më 11 prill 2026 zhvilloi takimim e radhës me nxënësit e mejtepit të ri/kursit fetar që mbahet në një qendër mësimore, pranë xhamisë së lagjes Rus.

Fillimisht, teologu Halluni mbajti një

bashkëbisedim, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin në përcimin te brezi i ri i mësimave të vërteta

fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, drejtuesi arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, zbatimin e programit mësimor të Myftinisë Shkodër,

pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga hoxhë Gilman Molla.

Në fund të takimit u zhvillua një bashkëbisedim i hapur më nxënësit e mejtepit.






MYFTINIA SHKODËR



Haxh TË PRANUAR



HAXHILERËVE TË SHKODRËS, TË SHQIPËRISË DHE TË MBARË YMETIT ISLAM!

Pejgamberi (a.s) ka thënë: **“Haxhi i pranuar nuk ka shpërblim tjetër, veçse xhenetin!”**

(Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi)

ME ZEMËR TË MIRË KURBAN BAJRAMIN!

E MËRKURË, 27 MAJ 2026 | BAJRAMI FALET NË ORËN: 6.15

 www.myftinia-shkoder.org



  @Myftiniashkoder1990

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org